REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 71/17
Datë/Datum. 06.04.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 71/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje Z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Tefik Sylejmani - Referues, z. Goran Milekovic - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Instituti për Shkencë dhe Teknologji" INSI "sh. p .k-Prishtinë, kundër vendimit për dhënie të kontratës të AK-KK /Komuna Kamenicë/ lidhur me aktivitetit të prokurimit me titull: "Hartimi i hartës zonale të Komunës " me nr. prok. KM 653/16/019/221, me datës: 04. 04. 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>Aprovohet</u>, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "INSI"sh. p. k-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit titull: "Hartimi i hartës zonale të Komunës " me nr. prok. KM 653/16/019/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /Komuna Kamenicë /.

II. <u>Anulohet,</u> njoftimi për dhënie të kontratës AK-KK /Komuna Kamenicë/ lidhur me aktivitetin të prokurimit, me titull: "Hartimi i hartës zonale të Komunës " me nr. prok. KM 653/16/019/221, ndërkaq nëse edhe me tutje AK ka interes për këtë aktivitet të prokurimit, lëndën ta kthej ne Ri-tender.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues, që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

V. Me qenë se pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues "INSI" sh. p. k Prishtinë, janë të qëndrueshme, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:12. 08. 2016.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 01. 09. 2016, ku kanë marr pjesë tre operator ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:01.03.2017 ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Vizion Project" Prishtinë.

Kundër njoftimit për dhënie te kontratës të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik "INSI" sh. p. k Prishtinë me dt: 03. 03. 2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 06. 03. 2017, autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "INSI" sh. p. k- Prishtinë.

Operatori ekonomik ankues "INSI sh. p. k"- Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 10 mars 2017 me nr. 71/17 kundër njoftimit për dhënie te kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, "Hartimi i hartës zonale të Komunës " me nr. prok. KM 653/16/019/221, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues AK-KK Komuna Kamenicë, duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 59- Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 7- Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 24. 03. 2017 bazuar në sqarimet e cekura në raport mendon që Autoriteti Kontraktues – Komuna Kamenicë, për aktivitetin e prokurimit "Hartimi i hartës Zonale të Komunës" me nr. të Prokurimit: KM 653/16/019/221, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së, konkretisht nenin 7 dhe 59 të LPP-së. Prandaj, eksperti shqyrtues i ka rekomanduar panelit shqyrtues që të APROVOJ si të bazuar ankesën e OE ankues dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Ri-tenderim nëse edhe më tutje ka interes AK-ja për këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti kontraktues, me datë 26. 03.2017, me anë të përgjigjes me shkrim, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues përmes përgjigjes me shkrim të dt: 27. 03. 2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23. 02. 2017, e cila është mbajtur pa praninë e palëve konform nenit 28.1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për dhënie të kontratës procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues deklaroj: "Në bazë të sqarimeve që kam cekur ne raportin e ekspertizës mendoj që AK-KK Kamenicë për aktivitetin e prokurim hartimi i hartës zonale të Komunës me nr te prok: KM 653/16/019/221, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së, konkretisht neni 7 dhe 59 të LPP-së, andaj i rekomandoj panelit shqyrtues që ta aprovoj ankesën e OE ankues si të bazuar dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në Ri-tenderim dhe nëse më tutje AK ka interes për këtë aktivitet të prokurimit".

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues deklaroj: "Qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës 24. 03. 2017".

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke pasur parasysh raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë, konstaton se operatori i rekomanduar për kontratë "Vizion Project" Prishtinë nuk plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit, pasiqë ka ofruar listën e inxhinierëve në të cilën ka caktuar të njëjtin inxhinier, menaxher të projektit si dhe inxhinier te arkitekturës. Sipas shkresave të lëndës dhe fakteve të ofruara, paneli shqyrtues ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar menaxher të projektit, inxhinierin e arkitekturës, ndërkaq kërkesë e Dosjes së Tenderit ka

qenë që të ofrohet menaxheri i projektit, veças menaxherëve tjerë të kërkuar në FD. Në këtë rast, AK- KK Kamenicë nuk ka vepruar konform nenit 7 dhe 59 të LPP-së me rastin e vlerësimit të ofertave të OE-ve pjesëmarrës.

Paneli shqyrtues duke analizuar me kujdes provat dhe faktet e ofruara, konstatoj se AK nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së, dhe nga provat e prezantuara më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Kamenicës

1x1 OE "Instituti për shkencë dhe Teknologji"-Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.